

TAKIMI I MUSLIMANIT ME KRISTIANIN  
A ESHTË . BIBLA E SHENJTE  
DOKTRINA E TRINISE SE SHENJTE  
DOKTRINA E SHENJTERISE SE JEZU KRISHTIT  
DOKTRINA E LINDJES HYJNORE TE JEZUSIT  
A U KRYQEZUA JEZUSI?  
DOKTRINA E LARJES SE MEKATIT DHE NATYRES MEKATARE TE NJERIUT

MUHAMEDI NE BIBEL

ISHMAELI DHE ISAKU ISHIN QE TE DY TE BEKUAR  
PERCAKTIMI I PROFETIT NGA XHEREMIA  
DERI NE ARDHJEN E SHILOHUT

A PERMENDET MEKA NE BIBEL  
"BEKA" ESHTË MEKKA  
SHTEPIA E LAVDISE TIME THOTE ZOTI  
KOCI ME GOMER DHE KOCI ME DEVE  
PROFETI QE DO T'I NGJANTE MOISIUT  
SHERBETORI, LAJMETARI DHE I ZGJEDHURI IM  
BEKUAR QOFSHIN PAJTUESIT"  
NDIHMESI ,SHPIRTI I SE VERETETES (MUHAMEDI A.S)  
ZOTI I REVELON (SHPALL) PROFETIT MUHAMMED (PQMT)  
PERMENDET ISLAMI NE BIBEL  
A ISHTË JEZUSI ZOT?  
ETJTAKIMI I MUSLIMANIT ME KRISTIANIN

Kristiani---- Nese te tri besimet: Judaizmi, Kristianizmi dhe Islami thone sa vijne nga i Vetmi dhe i njejtj Krijues, perse ndryshojne ate here?

Muslimani---- Te tere profetet nga Adami tek Muhamedi (PQMT) u derguan me te njejtin mesazh, e ky mesazh ishte nenshtrim i plote i njerezimit ndaj Allahut. Ky nenshtrim ne Arabisht quhet Islam, Islam do te thote gjithashtu Paqe, paqe ndermjet Krijuesit dhe krijesave te Tij. Ne ndryshim nga Judaizmi dhe Kristianizmi, emri Islam eshte dhene nga Allahu, nga vete Ai dhe ne Suren 5:3: "Sot juve ua kam perkryer fene tuaj, dhe begatine time ndaj jush e kam plotesuar, dhe jam i kenaqur qe Islami do te jete fe e juaj". As emri "Judaizem" e as emri Kristianizem" nuk gjendet ne Bibel, madje as ne fjaloret Biblike. Asnje profet izraelit nuk e permendi fjalen "Judaizem". "Jezusi kurre nuk e shpreh se donte te vendoste Kristianizmin mbi toke dhe kurre nuk e shpalli veten Kristian. Fjala Kristian permendet vetem 3 here ne Dhjaten e Re e per here te pare nga paganet dhe çifutet ne Antioki rreth vitit 43 te eres sone, shume kohe pasi Jezusi e kish lene kete bote. Lexo veprat e Apostujve 11 :26:... ketu ne Antioki nxenesit per here te pare i quajten te krishtere".

Me vone Mbreti Agripa i dyte i thote Palit, lexo veprat e Apostujve 26:28:"Agripa iu pergjigj: "Edhe pak dhe po ma mbush mendjen te behem i krishtere. Pra ishin armiqte e jo miqte ata qe e perdoren per te paren here emrin "Kristian." Se fundi ky emer permendet nga Pjetri ne nje leter ngushelimi derguar nje besimtari, lexo letra e Pare e Pjetrit 4:16;" Por ne qoftese e peson per arsye se eshte i krishtere, nuk duhet te kete turp..."

Myslimani i pare ne toke nuk qe Muhamedi, por Abrahami i cili iu nenshtrua plotesisht Allahut. Por Islami, si menyre te jetuari, u eshte treguar Profeteve qe kane qene edhe me pare se Abrahami si Adamit dhe Noes. Me pas Islail erdhi si mynyre te jetuari ,per gjithë njerzimin.

Kristiani---- Si mund te ishte Abrahami Mysliman? Ai njihet si çifut!  
Muslimani---- çifut? Kush ua tha kete?

Kristiani---- Keshtu na e kane mesuar, madje dhe Bibla duhet ta kete konfirmuar.

Muslimani---- Mund te na tregosh se ne eilen pjese te Bibles thuhet se ai eshte çifut?

Nese nuk e gjen dot shpejt, po te ndihmoj.  
Lexo Gjenezë 11 :31

Kristiani----"Terahu mori te birin, Abramin, nipin e tij Lot, birin e Haranit, gruan e Abramit, Sarani dhe se bashku u nisen nga Uri Qaldijaneve, per te shkuar ne Kanan. Dhe kur mberriten ne Haran u vendosen aty pergjithmone".

Kristiani---- Pra Abrahami nuk mund te kete qene çifut. Se pari, sepse Uri i ({aldijaneve ku ai lindi ishte ne Mesopotami qe tani eshte pjese e Irakut. Pra ka qene me teper Arab sesa çifut. Se dyti; emri çifut filloi te perdorej pas vdekjes se Judes, sternipit te Abrahamit (shih tabelen fqA) Lexo me tej ne Gjenezen 12:4-5.

[B]Kristiani---- "...dhe kur Abrahami u largua nga Harani, ai ishte shtatedhjetë e pese vjeçç...dhe ne token e Kananit ata mberrine".[/B]

Muslimani---- Pra Abrahami emigroi ne Kanan ne moshen 75 vjeçare dhe Bibla e thote qarte se atje ai ishte plotesisht i huaj Gjenezë 17:8:" Ty dhe atyre qe do te vijne pas teje une do tua jap te tere token e Kananit, ku ti je i huaj, perta pasur tuajen ngahera; dhe une do te jem Perendia i tyre." Tani lexo Gjenezen 14:13.

[B]Kristiani---- "Njeriu qe shpetoi erdhi e ia tha kete Abram Hebreut."[/B]

Muslimani---- Si mund ta quani Abrahamin çifut kur vete Bibla e quan Hebre qe do te thote banues i bregut tjetër te Eufratit. Po ashtu ajo do te thote se ai i perket Eberit, pasardhes i Shemit. lexo tani "Gjenezen 32:28 se çfare i ndodhi emrit te Jakobit pas luftes me engjellin.

[B]Kristiani----"Dhe ai i tha, emri yt nuk dO te jete me "Jakob", por "Izrael" sepse ti luftove me Zotin dhe me njerezit."[/B]

Muslimani---- Pra Abrahami qe Hebre. Pasardhesit e Jakobit qene Izraelitet qe perbeheshin nga 12 fise. Juda u mbiquajt "çifut" ndaj ne fillim çifute u quajten vetem pasardhesit e Judes. Lexo Eksodi 6:16-20, per te mesuar se cili qe Moisiu ne te vertete.

[B]Kristiani---- Emrat e bijve te Levit sipas breznive ish in: Ghershon, Kanath, Merari...Dhe bijte e Kanathit qene: Amrami... Amrami u martua me motren e te jatit e cila i lindi Aaronin dhe Moisiun."[/B]

Muslimani---- Keshtu pra Moisiu nuk qe çifut,pasi nuk rridhte nga Juda por nga Levi. Moisiu qe "ligj-dhenesi"(Torah eshte ligji) i bijve izraelit.

Kristiani---- Po kesaj ç'shpjegim i jepni?

MUSLIMANI: Sepse ne perdorim si standart Kur' anin e Shenjte. Mund ta shpjegosh Biblen dhe te korrigjosh paragjykimet çifute e kristiane duke i pare brenda kontekstit te Kur'anit. Ai eshte i fundit liber i shenjte i cili nuk eshte falsifikuar apo perdhosur. Permbajtja e tij eshte vertetuar nga Allahu ne Suren 2:2 "Ky eshte libri qe nuk ka dy ne te"... e me pas ne Surean 15:9 "Ne me maderine tone e shpalleme Kur'anin dhe Ne gjithsesijemi mbrojtes te tij..."Ky varg eshte sfide per njerezimin. Eshte fakt se kane kaluar me teper se 1400 vjet dhe Kur'anit nuk i eshte ndryshuar asnje fjale, dhe ndonese te pafete bene çeshte e mundur per ta shtremberuar ata deshtuan me turp ne perpjekjet e tyre. Siç thuhet dhe ne vargun e shenjte "Ne gjithsesi jemi mbrojtes te tij".e per Allah, Ai e ka ruajtur.

Ne te kunderten, te gjitha librat e tjere te shenjte (Torahu.. Psallmet, Ungjijte, etj Jane perdhosur ne formen e shtesave, redaktimeve apo ndryshimeve te origjinalit.

Kristiani---- çfare thote Kur'ani per Abrahamin e Moisiun, qe te ben te nxjerresh nje pertundim te tille per Biblen?

Muslimani---- Ne Suren 3:65 thuhet: "O ithtare te librit, pse po polemizoni me ne rreth Ibrahimit? E, nuk jane shpallur as Tivrati, as Inxhmi, vetem se pas tij?1 A. nuk e kuptoni?"

Dhe ne Suren 3:67 thuhet: "Abrahami nuk ish as jehudi e as i krishtere por ai ishte larg besimeve te kota, ishte mysliman dhe nuk ishte prej idhutareve."

Ne Suren 2:140 thuhet: "A pretendoni se Abrahami, Ishmaeli, Isaku, Jakobi dhe pa(ardhesit e tij qene çifute ose kristiane? Thuaj (O Muhammed). "A e dini ju me

mire apo Allahu? Kush eshte me mizor se ai qe e ka deshmine Allahut tuaj prane vetes dhe e fsheh; Allahu nuk eshte i panjoftuar me veprimet"

Patjeter qe ata nuk qene as çifute e as kristiane, pasi emri "çifut" u perdor pas Judes dhe emri "kristian" erdhi shume kohe pasi,kish ikur Jezusi.

Kristiani----Eshte paksa e cuditshme te degjosh emrin "Allah". Kur dini te flisni Anglisht perse nuk perdomi "God" (Zot).

Muslimani---- Po, eshte e vertete qe per jo-myslimanet emri Allah tingellon paksa i çuditshem, por ky emer eshte perdorur nga te tere Profetet, qe nga Adami deri tek Muhammedi (POMT). Ai vjen nga bashkengjitja e dy fjaleve arabe Al-llah, dmth Zoti. Bie germa "l" dhe keshtu formohet fjala "Allah". Ne varesi te pozicionit qe merr me nje fjali ne arabisht, kjo fjale mund te marre formen "Allah ", e cila i afrohet fjales qe perdorin Hebrenjte per krijuesin, dmth, "Eloha". Por perdorimi i formes se shumesis nga çifutet perben nje gabim sepse jep idene e me shume se dy Perendive. Forma "Allah" i afrohet fjales Aramaike "Alaha"= Perendi, te perdorur nga vete Jezusi (shih Enciklopedia Britanike, 1980, fjalet "Allah" dhe "Elahim"). Pra, ndersa per jo-myslimanet fjala " Allah" tingellon e çuditshme, ajo nuk qe aspak e çuditshme per profetet qe nga Adami e deri tek Muhamedi "POMT", pasi ne thelb ajo qe ata thone, ishte e njejta: Islam., dmth nenshtrimi i plote, dhe fjala Allah eshte emri i pervçem i Oenies Supreme. Kjo fjale nuk ka as shumes e as gjini, me nje fjale nuk kemi Allahet, as Allahun mashkull e femer, siç kemi ne krishterim Perendi, Perendia dhe Perendite. Per me teper perdorimi i fjales Perendi eshte teper i ngaterruar, pasi shume Kristiane qe flasin "anglisht vazhdojne ta konsiderojne Jezusin si Perendi. Madje dhe fjala "Krijues" nuk eshte shume e qarte, nga qe shume kristiane thone se kjo bote eshte krijuar prej Jezusit. I çuditshem nuk eshte vetem emri "Allah", por dhe menyra sesi myslimanet e adhurojne Allahun duke u pastruar, perkulur, gjynjenzuar dhe duke agjeruar. Te tera keto duken te cuditshme per ata qe nuk jane myslimane, por nuk kane qene aspak te çuditshme per te gjithë Profetetçdersa kristianet e kane braktisur zakonet e te pastruarit ( larjen e duare, te kraheve, kembeve si dhe lagjen e flokeve) perpara lutjes, ky zakon vazhdon te praktikohet nga myslimanet, ashtu siç praktikohet dhe nga profetet, gje qe duket qarte ne keto pjese te Bibles:

Eksodi 40:31-32: "Dhe Moisiu, Aaroni e bijte e tij, ne ate koM lane duart dhe kembet e tyre. Ata pastroheshin sa here qe hynin ne fatore dhe i afroheshin altarit. ashtu siç i kishte porositur Perendia Taoisine." Ndonese Pali beri shume ndryshime ne mesimet e Jezusit, ai vazhdoi ta permbushe me besnikeri e respekt ritin e te pastruarit siç duket dhe ne "Veprat e Apostujve" 21 :26:"Pali e ndoqi keshillen dhe solli me vete 4 njerezit. Te nesermen pasi u pastrua se bashku me ta, hyne ne tempull..."

Grate myslimane i kryejne lutjet me koke te mbuluar ashtu sic; thuhet ne letren e Pare Derguar Korintasve 11 :5,6 dhe 13 "Perkundrazi, eshte shenje mospenilljeje

ndaj burrit ne qotte se gruaja e tij e emancipuar lutet ose profetizon me koke te zbuluar gjate sherbeses fetare. Ajo sillet sikur te ishte prostitute me floke te qethur. E po ndodhi qe ndonje grua nuk do ta mbuloje koken, le te qethet (e le te perjashtohet). a mos eshte turp per gruan ne qofte se e qeth ose e rruan koken? Kjo eshte nje arsye e metejshme per te mbuluar koken e saj... Gjykoni ju vete: aka hije qe gruaja te lutet para Perendise me koke zbuluar?".

Myslimanet luten duke u perkulur, gjunjezuar, shtrire dhe pa kepuce ashtu si(.fluteshin dhe Profetet:

Psalmet 95:6: "Hajdeni te lutemi e te perkulemi, t'i gjunjezohemi Perendise, krijuesit tone." Joshua 5:14{ Joshua u perkul gjer me toke e filloi te lutej..."

Mbreterit 118:42: "Por Elija u ngjit ne maje te Karmelit; ai u ul mbi gjunje dhe fytyren e uli (vuri) ne mes kembeve."

Numrat 20:61"... dhe ata MOISIU DHE AARONI u perkulen gjer mbi dhe e perpara tyre u shfaq lavdia e Perendise."

Gjeneza 17:3 "Dhe Abrami u gjunjezua, e Perendia filloi te fliste duke i thene..."

Eksodi 3:5 dhe Veprat e Apostujve 7:33:"Dhe Ai(PERENDIA) i tha atij (MOISIUT) Hiqi sandalet sepse po qendron ne toke te shenjte."

Kristianet do te dridheshin po te dinin se peligrinazhi apo haxhilleku, siç i themi ne, i cili kryhet nga myslimanet duke u sjella rreth gurit ta shenjta Ka'bes . ne Meke, eshte kryer nga mjaft Profete, madje dhe nga Profete Izraelite.

Kristiani---- Ne Bibel nuk e kam hasur kurre haxhillekun apo gurin e Shenjte. Muslimani----Kjo permendet disa here e mjaft qarte, por lexuesit e Bibles nuk e vene re:

1."Kur ish nisur per ne Padan-aram Jakobit iu shfaq nje vegim dhe te nesermen ai ngriti nje shtylle prej guri te cilen e quajti "Beth-EI" dmth Banesa e Perendise (Gjeneza 28:18-19).

2. Vite me vone, po ky profet, Jakobi, u urdherua nga Allahu te shkante ne Beth-EI (Gjeneza 35:4,14,15). Perpara se te shkante atje, Jakobi hoqi te tere Perendite e huaja per te. Te njejten gje beri dhe Muhamedi me vone kur hoqi te tere idhujt e vendosur rreth gurit te shenjte: Ka'bes ne Meke.

3.Nje shtylletjeterguri ngriti Jakobi dhe vjehri i tij Laban (Gjeneza 31 :4549:" Jakobi ngriti nje kollone te gurte. pasi e beri kete u tha te afermve: "Mblidhni gure" E ata mblodhen gure e ngriten nje pirc e mbi ate pirc u shtruan te hane buke. Labani e quajti "Jegar-sahadutha" por Jakobi i vuri emrin "Galeed.." Dhe "Mizpah"; sepse ai tha: "Perendia ruajte mes meje e teje ..."

4. "Xheptahu dhe Amoni ishin ne lufte mes tyre. Xheptahu iu betua Perendise perpara Mizpeutte Giledit se, "nesa fitonte do te bente tli bijen e tij te vetme. Ai e flijoi dhe e dogji te gjalle vajzen e tij te vetme si kurban per Perendine (Gjykatesit 11 :29-39)

5. "400.000 shpatare nga 11 fiset e Izraelit u betuan perpara Perendise ne Mizpah se do te zhduknin nga faqja e dheut fiset e Benjaminit" ( Gjykatesit 20 dhe 21).

6. "Bijte e Izraelit nen udheheqjen e Samuelit u betuan ne Mizpeh se nese do te fitonin kunder Filistineve do ti shkaterronin idhujt e tyre" (I Samuel 7)

7. Kur Samueli u caktua mbret i Izraelit, i gjithë kombi u mblodh ne Mizpeh (I Samuel 10).

Pra, eshte me se e qarte se ne bote nuk ka mbetur asnje Mizpeh, veç atij me te vjetrit ne qytetin e Shenjte te Mekes, . ndertuar nga Abrahami dhe i biri Ishmaeli prej te cileve rrjedh dhe Profeti Muhamed. Myslimanet jane me te vertete ndjekes te te gjithë Profeteve. Mund-te te tregoja edhe mjaft gjera te tjera rreth Myslimaneve, Islamit dhe Muhamedit (POMT) se si ata jepen ne Bibël, por perse te dish keto kur nuk kerkon te dish te verteten?

[B]Kristiani---- Kam mjaft besim ne perkushtimin tim si kristian, por kjo me nxit perte ditur me teper rreth te dy besimeve. Nganjehere me duket vetja i perqeshur kur lexoj libra te shkruatur prej myslimaneve.

Muslimani---- Ka influencuar kjo ne jeten tende fetare?

Kristiani---- Po, ndaj dhe tani nuk vete ne Kishe aq rregullisht si me pare. Fshehurazi lexoj libra shkruar prej myslimaneve. Shpesh kam pyetur disa Myslimane per ate gjera qe kisha te paqarta, po nuk mbetesha i kenaqur. Une kerkoj nje besim tek i cili mund te mbeshtetem, besim i cili te me jape paqen shpirtore dhe te jete i pranueshem e jo te besoj verbazi tek ai.

Muslimani---- Jam i nje mendimi me ty dhe e vleresoj qendrimin tend. Por ne nuk na lejohet te joshim askend. Ne u flasim vetem atyre qe desherojne te na degjojne.

Kristiani---- Megjithate une jam i lire te besoj ç'te dua dhe askush s'mund te me ndaloje. ;.

MUSLIMANI Po, eshte e vertete. Feja nuk e njeh detyrimin.por sipas zgjedhjes do kesh denim ose shperblim.

Kristiani---- Por atehere perse kerkojne myslimanet qe te tjerat ta pranojna

besimin e tyre?

Muslimani----Ashtu si kristianet u kerkojne çifuteve qe ta pranojne Jezusin si Mesia, ashtu dhe ne myslimanet u kerkojma kristianeve,çifuteve dhe gjitha njerezimit qe ta pranojne Muhamedin (POMT) si vulen e gjithë Profeteve. Profeti yne Muttamed (POMT) ka thane: " Jepja fjalen time edhe nje sherbyesje (varg j Kur'anit te Shenjte)"

Po keshtu Isaja perm end ne kapitullin 21 :13 "Pesha mbi Arabine" qe do te thote pergjegjesia e Arabeve Myslimane, dhe tani e tare myslimanve, per te perhapur Islamin. Isaja i thote keto fjale pasi sheh nja vegim, ku jane nje karroce me gomere e nje me deve (21 :7):"Ai pa dy kalores mbi karroca, nje karroce e mbrehur me gomere e nje e mbrehur me deve:"

Karroca me gomere doli se qe Jezusi i cili hyri ne Jeruzalem mbi te (Gjoni 12:14: Mateu 21 :5) Cili qe atehere karroca me deve? S'mund te kete qene tjetër njeri vec; Muhamedit (paMT), i eili erdhi 600 vjet pas shtaqjes sa Mesise. Nese kjo nuk pranohet atehere profetesia e tij eshte permbushur.

Kristiani----Keto shpjegime me nxisin qe ta lexoj Biblen me me teper kujdes. Do te me pelqente qe te diskutonirr.me teper se bashku.

Muslimani----Patjeter, te jesh i suksesshem na kete bote nuk do thote se dote jesh I tille dhe ne tjetren: Jeta tjetër eshte shume me e mire e shume me e gjate. Tani njerezit jane here materialiste e te ngushte. Le te takohemi e ti diskutojme dallimet mes feve tona hapur e pa paragjykime. Islami bazohet mbi arsyen nuk pranon qe gjerat te pranohen me symbyllur. Madje dhe Bibla thote: "Por shqyrtoni me kujdes çdo profeci dhe pranoni vetem ate qe eshte me e mire".(Letra e Pare Drejtuar Selanikasve 5:21)

Kristiani----Tani sapo citove nga Isaja "karroce me deve" dhe nga kjo dola ne konkuzionin se ky eshte Muhamedi. Eshte profetizuar atehere ai ne Bibel?

MUSLIMANI Sigurisht.

Kristiani---- Ne Dhjaten e Re apo te Vjeter?

Muslimani----Ne te dyja. Por per sa kohe qe nuk pranon se Perendia eshte Nje nuk do ta njohesh (Muhamedin) kurre ne Bibel!. E kam tjalan per sa kohe qe te besosh ne Trinine e Shenjte, Hyjnesina e Jezusit, ne Jezusin si bir ta Perendise, ne natyren mekatore te njeriut dhe na shlyerjen e mekatit. Te gjitha doktrinat jane shpikur prej njerezve. Jezusi profetizoi (Mateu 15:9) se njerezit do ta adhurojne me kot dhe do te besojne na doktrina te bera nga vete njerezit "Par me kot me adhurojne mua, sepse vetem masojne urdharesa te shpikura nga njerezit. "1) A ESHTË . BIBLA E SHENJTE

Muslimani---- A je i sigurt se Bibla eshte e shenjte?

Kristiani---- Sigurisht qe jam ajo eshte fjala e Perendise

Muslimani---- Lexo atehere se çfare thote luka mbi ato qe ka shkruar vete, {luka kapitulli 1:2-3.

Kristiani---- "Keto raporte na i lane ata qe ishin deshmitare te atyre ngjarjeve dhe u ngarkuan me detyren e shpalljes se lajmit te mire. Per kete arsye vendosa dhe une t'i shqyrtoja te gjitha me kujdes qe nga fillimi, dhe t'i shkruaj me rradhe, saktesisht, per ty, i Toofil, shkelqesia juaj".

Muslimani- Si mund te vazhdosh te besosh se Bibla eshte fjala e Perendise kur vete Luka thote se ai nuk qe deshmitar dhe gjithçka e mblodhi prej deshmitaresh te tjere e jo nga fjale te frymezuara prej Perendise?

Kristiani---- Ndoshta vetem kjo pjese nuk eshte fjale e Perendise.

Muslimani---- Historia tregon se Bibla u eshte nenshtruar ndryshimeve ne te gjitha

epokat. "The Revised Standard Version" 1952 dhe f971 "New American Standard Bible" dhe "New World Translatio.n" kane hequr mjaft vargje te Versionit te Mbretit Xhejms. Reader's Digest skartoi 50% te Dhjates se Vjater, ndersa Dhjaten e Ra a ngjeshi ne 25%. Mos do te thote fjala "a shenjte" sa Bibla nuk ka gabime.

Kristiani---- Po ashtu eshte. Por per çfare gabimesh e keni fjalen?

Muslimani---- E zeme' se ne njeren vjershe thuhet se nje person vdiq ne moshen 50 vjeçare, ndersa ne nje tjetër po ky person thuhet se vdes ne moshen 60 vjeçare. A mund te jene te dy pohimet te verteta?

Kristiani---- Jo, te dyja nuk mund te jene kurre te verteta. Ose njera eshte e drejte e tjetra e gabuar ose te dyja jane te gabuara.

Muslimani---- Nese nje liber i shenjte permban vargja kontradiktora a mund te vazhdosh ta konsiderosh te shenjte?

Kristiani---- Sigurisht qe jo, sepse shkrimi i Shenjte eshte reveluar nga Zoti dha eshte e pamundur qe te permbaje gabime apo vargje kontradiktore.

Muslimani---- Pra nuk eshte i shenjte

Kristiani---- Drejt, nga shenjteria e tij nuk mbetet asgje.

Muslimani- Po qe keshtu atehere si beson dot plotesisht. Cila mund te jete arsyeja e ketyre te metave?

Kristiani---- Ndoshta mund te jene gabime qe jane bare gjate shkrimit le librit ndryshime te qellimshme kryer nga shkruesit, shtime dhe redaktime.



Muslimani- Nese Bibla do te permbante vargje kontradiktore, a do te vazhdoje ta konsideroje te shenjte?

Kristiani---- Besoj se Bibla eshte e shenjte, pasi ne te nuk shoh asgje kontradiktore.

Muslimani---- Ndersa una them se ne te ka mjaft vargje kontradiktore.

Kristiani---- Ne Dhjatan e Re apo te Vjeter?

Muslimani---- Kontradikta gjen ne te dy Dhjatat. Ja disa prej tyre:

II Samuel 8:4

Dhe Davidi mori prej tij 1000 karroca, shtateqind kalores dhe njezet mije kembesore.

{I Kronikat , 18:4 Dhe Davidi mori prej tij nje mije karroca, shtate mije kalores dhe njezet mije kembesore.

Pyetje: Shtateqind apo shtate mije?

{II Samuel 8:9-10} Kur Toi, mbret i Hamateve degjoi se Davidi kish mundur ushtrine Hadadazerit atehere Toi dergoiv joram in birin e tij qe te pershndeste e uronte davidin pasi kishte luftuar dhe mundur hadadazerin, I cili kish qene ne lufte me toin. Jorami mori me vete plor sende ari, argjendi dhe bronxi.

{I Kronikat 18:9-10} Kur Tou mbret I I hamateve degjoi se si Davidi kishte mundur te gjithë ushtrine e Hadarezerit mbretit te zobahut. Ai dergoi tk davidi birin e tij hadoram qe ta pyeste dhe pergezonte mbi fitoren e Hadarezerit dhe me vete I dha plot sende ari argjendi dhe bronxi.

Pyetje: Toi apo Tou. Joram apo Hadoram, Hadadezer apo Hadarezer?

{II Samuel 10:18

Dhe sirianet ia mbathen perpara

Izraelit, dhe Davidi vrau ushtaret e shtateqind karrocave siriane dhe dyzet mije kalores. ai mundi Shobahun, komandantin e tere ushtrise, i cili vdiq aty.

Kronikat I 19:18

Por sirianet ia mbathen perpara

Izraelit; dhe Davidi vrau shtate mije ushtare siriane mbi karroca dhe dyzet mije kembesore si dhe vrau Sho pahun, Komandantin e Hire ushtrise.

Pyetje: Shtateqind karroca apo shtate mije ushtare? Dyzet mije kalores apo

kembesore? Shobahun apo Shopah?

II Mbreterit 8:26

Ahaziahu ishte njezet e dy vjeç; kur filloi te mbreteronte.

Ii Kronikat 22:2

Ahaziahu ishte dyzet e dy vjeç; kur filloi te mbreteronte.

Pyetje: Njezet e dy apo dyzet e dy?

II Mbreterit 24:8

Jehoakimi qe tetembedhjete vjeç kur filloi te mbreteronte dhe ai mbreteroi ne Jeruzalemper tre muaj.

II Kronikat 36:9

Jehoakimi ishte tete vjeç; kur ai filloi te mbreteronte dhe ai mbreteroi Jeruzalem tre muaj e dhjete dite,

Pyetje: Tete apo tetembedhjete vjec;? Tre muaj apo tre muaj e dhjete dite?

II Samueli 23:8

Keto qene emrat e trimave te Davidit: Takmoniti i eili ulej mbi fron e qe komandant i komandanteve; I tille qe dhe Adino, Ezniti: ai ngriti sopaten e me nje te qelluar vrau teteqind vete.

I Kronikat 11 :11

E ky eshte numri i trimave qe kishte Davidi Jashobeam, nje Hakmo-nit, i eili qe komandant i komandanteve ai ngriti sopaten e me nje te qelluar vrau treqind vete.

Pyetje: Takmonit apo Hakmonit? Teteqind apo treqind.

II Samueli 24:1

Perseri u ndez zemerimi I Perendise kunder Izraelit dhe Ai e nxiti Davidin, duke i thane "shko dhe numero Izraelin dhe Juden."

I Kronikat 21 :1

Satanai (djalli ngrit kunder Izraelit dhe e nxiti Davidin qe te bente nje numerim te popullsisë se Izraelit.

Pyetje: Mos eshte Satanai Zoti i Davidit? Mos O Zot!

{II Samueli 6:23[B] Dhe Mikela , bija e Solit nuk pati femije deri sa vdiq}

II Samueli 21:8

Por mbreti mori Armonin dhe Mefiboshetuin, dy djernte e Rizpahut, vajzes se Ajahut, qe ajo i kish lindur me Solin; se bashku me pese djemte e Mikalit, bijen se Solit, te cilet ajo i kish lindur me Adreielin birin e Barzilait, Meholait.

A Pyetje: Kishte apo nuk kishte femije Mikela?

Vini re: Emri Mikel qe perdoret ne librin e dyte te Samuelit gjendet si ne versionin e Mbretij Xhejms, ashtu dhe na botimin "New Wold Translation" i shkrimeve te shenjta, perdorur nga Doshmitaret e Jehovahit, por e botimin e vitit 1973 "New American Standard Bible" ky emer eshte ndryshuar na Merab

Kristiani---- Kjo nuk me kish rene kurre ne sy me pare? A ka te tjera?

Muslimani- Kerkon te dish me teper? Nuk eshte kjo e mjaftueshme per te mohuar shenjterine e Bibles?

Shih Gjenez 6:3: "Dhe Zoti tha,- Shpirti im nuk do te mbese pergjithmone tek njeriu, pasi ai ashte i vdekshem; ai do te jetoje njeqind e njezet vjet" Por sa vjeç; ishte Noahu kur vdiq? Mbi njeqind e njezet vjeç:?

Shih Gjenez 9:29:" Dhe Noahu vdiq kur kish mbushur nenteqind e pesedhete vjec", Disa teologe kristiane thone sa njeqind e njezet vjetet nuk jane mosha maksimale e njeriut; por koha kur do te ndodhte permbytja, Por as kjo fluk perputhet' me Biblen, pasi ne kohen e permbytjes Noahu duhet te keto qene gjashteqind e njezet vjeç(500+ 120), ndersa Bibla thote se ai ishte gjashteqind vjeç, Studioni keto vargje; Gjenez 5:32 "Dhe Noahu ishte peseqind vjeç" Gjenez 7:6 "Dhe Noahu ishte gjashteqind vjeç kur ujet e permbytjes mbuluan token...,"

[Isaja 40:18-25: "Me cilin doni ta krahasoni Perendine? Me çpamje doni ta perqasni?..Me cilin doni te me perqasni? Apo cili eshte i barabarte me mua?"-tha Shejteria e Tij" Po ashtu shih Psalmet 89:6: "Cili nga ata, ne qiejt e siperm mund te krahasohet me Perendine? Kush nga qeniet hyjnore eshte si Perendia?" Dhe Xheremia 10:6,7:" Asnje nuk eshte si ty O Zot...asnje nuk eshte si ty".

[Jeremia 8-8]Si mund te thoni, 'ne jemi te mencur, dhe ligjet e Zotit jane me ne'? Por, kujdes, penda e shkruesve (te bibles) e ka kthyer ne Genjeshter.

Kristiani---- Por, te tera keto bejne pjese ne Dhjaten e Vjeter

Muslimani-- Ti kthehemi Dhjates sa Re tani.

Gjoni 5:37 Gjoni 14:9

"Ju nuk e degjuat kurre zerin e "...,Kush me pa mua,pa edhe tij as nuk e pate formen e tii" Atin"

Gjoni 5:31 Gjoni 8:14

"Neqoftese dote deshmoja per "Jezusi u pergjigj dhe u tha, vetveten, deshmia ime nuk do te. Ndonese une deshmoj per vetveten ishte e vertete deshmia ime eshte e virtete" .,

Keto jane vetem disa nga kontradiktat qe gjenden ne Dhjaten e Re. Te tjera do te dalin nese do te diskutonim se bashku doktrinat e Kristianizmit modern si; Trinine e Shenjte, shenjterine e Jezu Krishtit, Lindjen Hyjnore te Jezusit, natyren mekatore te njeriut dhe larjen e fajeve, pa permendur zvetenimin e mjaft Profeteve ne Bibel,si adhuronjes te Perendive te rreme, duke i akuzuar gjithashtu per incest, perdhunim dhe tradheti bashkeshortore.

[B]Kristiani---- Po keto ku gjenden ne Bibel?

Muslimani---- Tregohet se Noahu u be aq tape saqe u zhvesh lakuriq ne sy te bijve

(Gjeneza 9:23-24): "Shemi dhe Jafeti moren nje rrobe dhe u kthyen duke ia hedhur mbi supe, duke mbuluar me te lakuriqesine e te jatit; fytyrat nuk i kthyen dhe nuk e pane te jatin lakuriq. Kur Noahu u permend, ai e kuptoi se 9fare i kishte bore djali me i vogel" .

Solomoni u akuzua jo vetem sepse kishte nje harem te madh, par edhe bashke adhuronte Perendi te rreme (I Mbreterit 11 :9-1 O)"Dhe Zoti u zemerua me Solomonin...Ai e kish keshilluar qe te mos.shkonte pas Zotave te tjere: par Solomoni nuk e perfilli urdherin e te Plotfuqishmit."

Aaroni; si Profeti qe kish shoqeruar Moisiun pertek Faraoni, u akuzua se u kish dhene izraeliteve per te adhuruar nje vije te arte (Eksodi 32:4):"Ai (AARON I) i mori te gjitha VETMET E FLORINJTE) dhe me ane te nje vegle u dha formen e nje idhulli qe paraqiste nje vije te arte; dhe ata thane: keto qofshin zotat e tu, O Izrael, te çilet te nxorren nga toka e Egjyptit".

Po keshtu do te lexosh incestin e Profetit Lot me dy bijat e tij (Gjeneza 19:36 "keshtu dy vajzat e Lotit mbeten shtatzena nga babai i tyre".

Do te lexosh per nje Profet, i cili u martua ne te njejten kohe me dy motra

(Gjeneza 29:28)"Jakobi keshtu ben. Javen e perfundoi me ato, ndersa me pas ai (LABANI) i dha per grua vajzen e tij, Rashelen." .

Dhe nje Profet tjetër, i akuzuar per tradhëti bashkeshortore

(Samueli 1111-4-5):"Atehere Davidi dergoi lajmetare per ta marre ate (gruan e Uriahut). Ajo erdhi e ai u shtri me te ajo u pastrua nga papastertia. Pastaj ajo u kthye ne shtepi. Gruaja u mbars dhe i dergoi Davidit fjale, duke i thene "Une jam shtatzene."

Pyetja ime eshte?: Si mund te pranohej Davidi ne gjeneologjine e Jezusit, kur ai e filloi me tradhëti bashkeshortore? Mos 0 Zot! A nuk bie kjo ne kundërshtim me ate çka thuhet ne Deuteronomi 23:22 "Asnje i lindur prej nje martesete paligjshme dhe asnjenga pasardhësi e tij deri ne brezin e dhjete nuk mund te hyje ne bashkesine e Perendise."

Nje tjetër shfaqje incesti, shoqeruar me perdhunim ishte ajo qe kreu Amoni, i biri i Davidit, mbi motren e tij, Tamaren (II Samueli 13:1.4:") Por ai, AMONI nuk pranoi ta degjonte dhe duke qene me i forte se ajo, e perdhunoi:" Nje tjetër perdhunim i Shumefishte ishte ai qe kreu Absalomi me grate e Davidit, siç tregohet ne I' Samuelin 16:33: "Keshtu ata i ngriten Absalo'nit nje tende mbi Qati dhe atjeai harboi me grate e te jatit perpara gjithë Izraelit".

(Nuk besoj se ka njeri te afte madje edhe mes barbareve, qe mund te kryeje diçka te tille).

Inçesti tjetër qe edhe ai ndermjet Judes dhe nuses se birit te tij, Tamares.

Rrugës per ne Timnam, ku do te shkonte per te qethur delet, ai pa Tamaren. Mendoi se ajo qe ndonje prostitute pasi fytyren e kishte te mbuluar. (Gjeneza 38:18):"Ai ia dha UNAZEN, BYZYLYKUN E TE TJERAT dhe fjeti me te, dhe ajo mbeti shtatzene prej tij."

Ndonese çifutet dhe muslimanet jane armiq me njeri tjetrin, asnje musliman nuk do te guxonte te shkruante nje liber ku profetet izraelite si Juda, Davidi, Jezusi (paqja dhe bekimi i Allahut qofte perhere mbi ta) te kryenin perdhunime, inçeste, prostitucion apo te shkelnin kuroren.

Te tere Profetet u derguan nga Allahu perte udhehequr njerezimin. Mos mendoni se Zoti nuk dergoi njerezit e duhur?

Kristiani----Jo, nuk jam i atij mendimi. Po ti nuk beson ne Bibel?

Muslimani----Ne vertets besojme ne te gjitha shkrimet e Shenjta, por ama kur ate jane ne formen e tyre origjinale. Zoti i dergoi çdo kombi Profet qe te sherbenle si paralajmerues dhe disa prej tyre kishin me vehte nga nje doreshkrim, i cili do te sherbente si udherrefyesh, vetem' per ate komb. Suhofi i Abrahamit, Torahu (pjese e Dhjates se Vjeter) i Moisiut, Zeburi (Psallmel) e Davidit dhe Inxhili (Dhjata eRe) i Jezusit. Asnje nga keto doreshkrime nuk ka mbetur ne formen e tij origjinale. Si pjese e planit te bere prej Allahut, Ai pertundimisht dergoi Muhamedin (paqja qofte mbi te) si vulen e tare Profeteve dhe i dha Kur'anin e Shenjte si udherrefyesh per tere njerezimin, kurdo dhe kudo qofte.

Jezusi vete tha se ai ish derguar vetem per tek populli i Izraelit (Mateu 15:24) "Zoti me dergoi vetem tek kopeja e humbur, tek populli i Izraelit." Gjithashtu (Mateu 1 :21) "Ajo do te linde djale: ti do t'ia vesh emrin Jezus (shpetimtar), sepse ai do ta shpetoje popullin e tij nga mekatet." Ai madje tha se nuk kishte ardhur per te ndryshuar por per te permbushur (Mateu:5:17-18): "Mos mendoni se erdha per te anuluar Ligjin e Moisiut dhe udhezimet e Profeteve. Nuk erdha per te anuluar ato, por per t'i permbushur. Une (Mesia) po ju them Derisa te jete qielli dhe toka, asnje shkronje dhe asnje presje nuk do t'i hiqet ligjil derisa ai te behet realitet."

Kristiani----Por ne ungjillin e Markut 16:15 Jezusi thote: "Dilni ne mbare boten dhe ia predikoni lajmin e mire te gjithë njerezve".

Muslimani---- Kjo bie ne kundërshtim me ate çka u tha me lart ne Mateun 15:24 dhe Mateun 1 :21. Se dyti, shume Bibla kane hequr vargjet 16:9-20 te ungjillit te Markut. "The New American Standard Bible" e ka vendosur kete pjese ndermjet kllapash dhe shkruan komentin e meposhtem "Disa nga doreshkrimet me te vjetra nuk i kane vargjet 9-20". "The New World Translation" i shkrimeve te shenjta qe perdoret nga deshmitaret e Jehovait, pranon se disa doreshkrime te lashta vendosin perfundime te gjata apo te shkurtra pas Marku 16:8 ndersa disa te tjera e lene deri aty. "The Revised Version" boton shenimin e meposhtem "Disa nga autoritetet me te lashta e mbyllin Ungjillin me vargun 8..." kjo tregon se edhe ringjallja e paraqitur ne Markun 16:19 nuk eshte e vertete.

Kristiani----Por Jezusi thote ne ungjillin e Mateut 28:19: Per kete shkoni dhe . mesoni ta gjithë kombet" "

Muslimani----"Gjithë popujt" duhet shpjeguar si 12 fiset e Izraelit; ndryshe do te binte ne kontradikte me Mateun 15:24 dhe Mateu 1 :21. Ne botimet "New American Standard Bible" dhe "New World Translation of Holy scriptures" kjo nuk perkthehet si "gjithë kombet" por si "te gjithë kombet". qe do te thote 12 fiset e Izraelit.

Dhe tani çmund te thuash per Biblen?

Kristiani---- Besimi im ka nisur te lekundet.

Muslimani---.Jam i sigurt se do te bindesh per autenticitetin e Islamit. pasi te kemi diskutuar edhe dallimet e tjera midis nesh. DOKTRINA E TRINISE SE SHENJTE

Muslimani----Vazhdon akoma te besosh ne Trinine?

Kristiani---- Sigurisht, madje kjo eshte shkruar edhe ne letren e pare te Gjonit (5:78) sepse ne qiell jane tre deshmitare, Ati, Fjala dhe Shpirti i Shenjte e keta te tre jane nje. Dhe tre deshmitare jane mbi Toke, shpirti, uji dhe gjaku. E te tre keta janje nje.

Muslimani---- Po eshte e vertete. Kjo gjendet ne version in e Mbretit Xhejms botuar ne vitin 1916 dhe ne ate kohe perbente nje nga bazat me te forta per doktrinen e Trinise . Por tani kjo pjese "Ati, Fjala dhe Shpirti i Shenjte dhe te tre keta jane nje," eshte hequr nga "Revised Standard Version" i vitit 1952 dhe 1971 si dhe nga mjaft Bibla te tjera duke u konsideruar si nje lluster e rreme qe kishte cenuar tekstin greqisht.

Ne botimin "New American Standard Bible" vargjet (5:7-8) te letres se pare te Gjonit jepen ne kete menyre: "Shpirti i. Perendise deshmon per kete dhe shpirti eshte e verteta, jane pra tre deshmitare: shpirti, uji dhe gjaku. Deshmite e ketyre pajtohen." Gjithashtu ne: "New World translation of the holy scriptures" te perdorur nga deshmitaret e Jehovait do te gjesh keto fjale:" Sepse jane tre deshmitare. Shpirti, uji dhe gjaku dhe deshmite e ketyre te treve pajtohen." Ne qofte se ti do te me thoje se nuk ke asnje dijeni per heqjen e kesaj pjese te rendesishme, do te te kuptoja fare lehte. Por ama çuditem se si nuk kane dijeni per kete tere ata predikues e prifterinj te fese se krishtere.

Triniteti nuk ashte diçka Biblike. Fjala "Trini" nuk gjendet as ne Bibel e as ne fjaloret Biblike. Ajo kurre s'u predikua nga Jezusi dhe ai nuk e permend askund. Nuk ka asnje lloj baze apo prove ne Bibel qe te na beje ta pranojme Trinine e Shenjte.

Kristiani---- Por megjihate ne Ungjillin e Mateut (28:19) gjenden fjalet "...Pagezujini ne emerte Atit, te birit e te Shpirtit te shenjte..." Kjo pjese nuk eshte hequr ende. Nuk perben ajo nje prove per ekzistencen e Trinitetit.

Muslimani----Jo, Ne qotte se do te kishim tre persona te cilet jane ulur e po hane se bashku, mos do te thote kjo se ata perbejne nje person? Jo. Formulimi i Trinise nga Athanasi, nje dhjak egjiptian nga Aleksandria, u pranua nga keshilli i Nikeas ne vitin 324 te eres sone, d.m.t.h me teper se 3 shekuj pas vdekjes sa Jezusit. Pa dyshim qe romaket duke qene pagane e duke patur nje Perandi Triune, influencuan mjaft mbi kete doktrine; Sathi ishte ndryshuar te dielen; 25 Dhjetori, e cila sipas mitologjise ishte dita e lindjes se Perendise se Diellit Mitra, u caktua si dita e lindjes se Jezusit ndonese bibla ne Librin e Xheremias (10:2-5)

parashikonte qarte dhe ndalonte zbulimin e pemeve te Krishtlindjes: "Keshtu tha Perendia; Mos ndiqni zakonet e kombeve te tjere e as mos u frikesoni nga shenjat qe jepen ne qiell ndonese te tjeret mund te tmerrohen prej tyre, pasi zakonet e popujve te tjere jane te pavlera; ata presin nje peme ne pyll dhe me dalte i japin forme. E zbukurojne me argjend dhe flori; dhe e gozhdojne per te mos levizur. Si dordolecet ne nje fushe me bostan, idhujt e tyre nuk mund te flasin; ato duhen mbajtur sepse nuk mund te ecin. Mos kini frike prej tyre. Prej tyre nuk vjen ndonje e keqe por ama nuk vjen dhe ndonje e mire". Meqe Kristianizmi ishte shmangur shume nga mesimet e verteta te Jezusit. Allahu atehere dergoi si pjese te planit te Tij profetin e Tij te fundit, Muhammedin per ta ringjallurbesimin dhe per t'i vene ne vend te gjitha keto ndryshime: kalendarin Julian i cili percaktoi eren kristiane, ngrenien e mishit te derrit, synetin e ndaluar prej Palit (letra derguar (Galatasve 5:2): "Me degjoni: une, Pali, po ju the[B]Muslimani---- ne qofte se pranoni te rrethpriteni (te beheni synet), Mesia s'do tju vlejje per asgje l"/[B] Kur'ani i Shenjte paralajmeron ne Suren 5:73: "Gjithashtu bene kufu'r (harG'm, mosbesim) ata qe thone: "Allahu eshte i treti i treve". S'ka ne gjithesi tjetër perveç nje Allahu, e nese nuk pushojne nga ajo qe thane (tre zotera), do t'i kape denim i dhembshem, ata qe nuk besuan prej tyre". . Vazhdon te besosh ende ne Trinine te cilen Jezusi s'e predikoi kurre?

Kristiani---- Por Perendia dhe Jezusi jane nje (Gjoni 14:11): " Me besoni mua: une jetoj ne Atin dhe Ati jeton ne mua."

Muslimani---- Lexo atehere Gjonin 17:21  
[B][B]Kristiani----' [B]Te lutem qe ata (dishepujt) te gjithë te jene nje. SiC je ti me mua e une me ty, le te jene edhe ata nje ne ne!"/[B]

Muslimani----Pra ketu del qarte se Zoti dhe Jezusi jane nje, por gjithashtu dhe dishepujt jane nje ne Jezusin dhe Zotin, sepse ai eshte ne Zotin. Ne qoftese Jezusi eshte Zot perse atehere nuk jane edhe dishepujt Zot duke qene se edhe ata si Jezusi jane ne Perendine? Nese Ati, Jezusi dhe Shpirti i Shenjte jane nje ne Trinine atehere po qe se do te perfshinim dhe dishepujt bashkesia Perendi do te perbehej nga pesembedhete vete.

[B]Kristiani---- [B]Por Jezusi eshte Perendl edhe sipas Gjonit 14:9:"...kush me pa mua, pa edhe Atin." .

(Gjeneza 21 :21), ne baze te nje plani te caktuar nga Perendia. Shtate here vrapoi ndermjet kodrave Safa dhe Merva duke kerkuar per uje;

Me 'vone ky veprim u kthye ne nje rit islam qe kryhet çdo vit nga miliona haxhinj qe shkojne ne Mekke nga e gjithë bota. Pusi i permendur ne Gjenezen 21 :19 ekziston ende dhe sot quhet Zemzem. Me vona Abrahami dhe Ismaili ngriten ne Mekke gurin s Shenjte Ka'ben. Po keshtu ekziston ende edhe vendi ku Abrahami kryente lutjet Tani ai quhet "Makam Ibrahim" d.m.th. vendqendrimi i Abrahamit. Gjate diteve te haxhillekut, haxhinjte therin na Meke mjaft bageti duke nderuar Ibrahimin (Abrahamin), Ismailin dhe dhuratën e tyre.

M.Por Bibla thote se ishte Isaku ai qe duhej te flijohej.

M. Jo, nuk eshte ashtu. Versioni Islam e shpreh qarte sa marreveshja ndermjet Perendise, Ibrahimit (Abrahamit) dhe djalit te tij te vetem u krye dhe u vendos ne ate kohe kur fli do te behej Ismaili. Po ate dite Ibrahimit (Abrahami), Ismaili dhe tere pjesetaret e familjes se tij u bene synet dhe kjo ndodhi ne nje \_kohe kur Isaku nuk kishte lindur akoma

(Gjeneza 17:24-27):"Kur u be synet Abrahami ishte 99 vjeç ndersa Ismaili 13; Abrahami u be synet ne te njejten dite me te birin dhe bashke me te u bene synet gjithë meshkujt e shtepise se tii".

Isaku lindi nje vit me vone dhe u be synet kur qe 8-ditesh

(Gjeneza 21 :45):"Abrahami e beri te birin synet kur ky qe 8-ditesh, ashtu siç e kishte keshilluar Perendia. Kur lindi Isaku Abrahami kishte mbushur 100 vjeç."

Pra marreveshja u krye dhe u vendos (berja synet dhe flijimi) kur Abrahami ishte

99 vjeç ndersa Ismaili 13. Isaku u lind nje vit me vone kur Abrahami ishte 1 00 vjeç.

Pasardhesit e Ismailit, Profeti Muhamed (PQMT) dhe deri myslimanet sot, vazhdojne ta zbatojne me besnikeri deri me ditet e sotme, marrieveshjen per berjen synet. Te pakten 5 here ne dite myslimanet perfshijne ne lutjet t tyre levdimin e Ibrahimit (Abrahamit) dhe pasardhesve te tij me levdimin e Muhamedit (PQMT dhe pasardhesve te tij.

M.Por, ne Gjenezen 22 thuhet se ishte Isaku ai qe duhej bere flij

Muslimani----. E di, por ama aty ka nje kontradikte. Aty thuhet shprehimisht "biri yt i vetem Isak". A nuk duhet te ishte shkruar "biri yt i vetem Ismail" pasi e dime se Ismaili ishte 13 vjeç, ndersa Isaku nuk kishte lindur ende? Kur lindi Isaku, Abrahami u be me dy djem. Shovinizmi ka bere qe ne te tere kapitullin 22 emri Ismail te ndryshohet ne Isak, por Perendia ka ruatur fjalen "i vetem" per te na treguar se cila eshte e verteta.

Fjalet qe gjenden ne Gjenezen 22:17 "Fara jote do te shtohet", i jane drejtuar Ismailit ne Gjenezen 16:10. Si shpjegohet atehere ky ndryshim i emrit te Ismailit ne Gjenezen 22? Po keshtu ne Gjenezen 17:20 dhe 21 :18per Ismailin perdoren fjalet" Ti do te kesh nje populi te madh", gje qe nuk thuhet per Isakun.

M.Cifutet dhe kristianet thone se Isaku ishte superior ndaj Ismailit. Muslimani----.Kete e thone ata, por jo Bibla (Gjeneza 15:4):"Tek ai ABRAHAMI mberriti fjala e Perendise qe i tha: Ky njeri ELIZEN I DAMASKUT nuk do te jete trashegimtari yt, ti do te trashegosh nje femije mashkull te lindur nga trupi yt".

Pra, edhe Ismaili ishte gjithashtu trashgimtar i Abrahamit. Gjeneza 16:10: "Engjelli i tha asaj( HAGARIT:) Fara jote do te shtohet kaq shume, sa ti nuk do te mundesh ti numerosh pasardhesit e tu".

Gjeneza 17:20:"1 degjova ate qe the per Ismailin. Une ate do ta bekoj dhe ai do te jete i begate e do te kete shume pasardhes. Ai do te linde 12 princer dhe prej tij do te dale nje populi i madh.

Gjeneza 21 :13:"Biri i sherbyses tende do te jete babai i nje kombi pasi ai eshte biri yt."

Gjeneza 21 :18:"Ngrije vogelushin,( ISMAILINj lart dhe shtrengoje fort ne duar, sepse prej tij do te rrjedhe nje populi i madh."  
Deuteronomi 21 ;15 17:"Nie burre ka dy gra. Prej tyre ai do vetem nieren, ndersa tjetren e urren . Me te dyja kane lindur femiiet e tii (djem), por djalit e pare e ka me gruan te cilen ai nuk e do. Kur te viie puna per te ndare pasurine te drejten e te parelindurit nuk duhet t'ia jape djalit te gruas qe do por atij qe i takon, dialit tjetere.

Duke pranuar si te parelindur djalin e gruas qe ai nuk e do. duhet qe edhe ti jape dy here me teper pasuri se djalit tjetër. Ky djale do te jete per babane e tij shenja e pare e fuqise. Vetem atij i takon e drejta e te parelindurit.[B][color]

Islami nuk e mohon se Perendia e bekoi Isakun dhe pasardhesit e tij, por biri i premtimit eshte Ismaili, prej te cilit me vone rrodhi Muhamedi (PQMT), si vula e te tere Profeteve.

Muslimani----.Por kristianet dhe çifutet pretendojne se Ismaili ishte nje femije i paligjshem. ?

Muslimani----.Kete e thane ata, por jo Bibla. Si mundet qe nje profet i madh, si Abrahami, te kishte nje grua ta paligjshme dhe nje femije jashte martesë.

Gjeneza 16:3:"...gruaja e tij( Sara) mori sherbetoren e saj egjyptiane te quatur Hagar dhe ia dha te shoqit per grua." Nese martesë e tyre qe e ligjshme, si mund te ishte i paligjshem femija i tyre! Mos eshte me pak e ligjshme martesë e dy te huajve, nje Babilonasi dhe nje Egjyptiani, sesa martesë ndermjet nje burri dhe motres se babai te tij? Nuk e dime nese kjo eshte apo jo shaka e Abrahamit, por fakti eshte se kjo gje thuhet edhe ne [color=darkblue][B]

Gjeneza 20:12:" Veç kesaj, ajo (Sara) eshte me te vertete motra ime nga ana e tim eti: dhe ajo u be gruaja ime."

Madje edhe emri "Ismail" u zgjodh nga vete Allahu;

(Gjeneza 16:11):" Engjelli i derguari nga Perendia i tha: Ti tani je shtatzene me nje femije dhe ai do te jete djale. Perendia e ka degjuar vuajtjen tende ndaj, emri i tij do te jete "Ismail." Ismail do te thote "Zoti degjon." Veç kesaj, ne cilin vend ne Bibel thuhet se Ismaili ishte femije i paligjshem.?

M.Askund ne Bibel!

Muslimani----.Shume kohe perpara se te lindtin Ismaili dhe Isaku, Allahu beri nje marreveshje me Ibrahimin (Abrahamin),

(Gjeneza 15:18):"... duke i thene Pasardhesve te tu: Une po i jap kete toke qe shtrihet nga lumi i Egjyptit deri tek lumi Euftrat."

A nuk ndodhet pjesa me e madhe e Arabise ndermjet lumenjve Nil dhe Euftrat, pikerisht aty ku duhet te jene edhe pasardhesit e Ismailit?

M.Mos do te thuash se Isaku dhe pasardhesve te tij nuk iu premtua asgje? '

Muslimani---- Ne myslimanet nuk mund te mohojme kurre qe Isaku u bekua nga Perendia.

Shih Gjeneza 17:18:"Ti dhe pasardhesit etu (Isaku) do te trashegoni sot e pergjithmone token e Kananit, ku ti tani je i huaj, dhe une do te jem Perendia juaj". .



A e ve re tani ndryshimin qe ekziston midis ketyre dy pjeseve. Abrahami ishte "i huaj" ne Kanan, por nuk ishte i tille ne token qe shtrihej midis Nilit dhe Euftratit. Si Babilonas ai ishte me teper arab se sa çifut.

M.Por sipas Gjenezës 17:21, marreveshja u be me Isakun: "Por marreveshjen time, une do ta vendos me Isakun qe Sara do ta linde pas nje viti.

M.Mos e perjashton kjo Ismailin? Ne cilen pjesete Bibles thuhet se Allahu nuk do te bente marreveshje me Ismailin?

Muslimani----Askund.

#### PERCAKTIMII PROFETIT NGA XHEREMIA

Xheremia 28:9:"Profeti i cili predikon paqen dhe profetesia e tij plotesohet do ta njihet si profeti i derguar me te vertete nga i Plotfuqishmi (Zoti)."  
Fjala Islam nenkupton Qetesine, paqen, paqe ndermjet Krijuesit dhe krijesave te tij. Por kjo profetesi e Xheremias, nuk mund t'i mvishet Jezusit, pasi ai deklaroi me gojen e tij se nuk erdhi per paqe(Luka 12:51-53):" A mendoni ju se kam ardhur ta sjell paqen ne toke? Jo, perkundrazi, percarje. Duke filluar qe tani, pese veta me nje shtepi do te jene te ndare ndermjet tyre; tre kundar dyve, dy kundertreve. Dote jete ati kunder birit, biri kunder atit, nena kunder bijes, dhe bija kundar nenes, vjehrra kunda nuses se saj, dhe nusja kunder vjehrrës." Shih gjithashtu Mateun 10:34-36.

#### DERI NE ARDHJEN E SHILOHUT

Ky ishte mesazhi qeJakobi u la femijave perpara se ta vdiste (Gjeneza 49:1):"Jakobi u thirri djemeve dhe u tha: Mblidhuni sepse tani do tu deftoj se 'çfare do t'ju ngjase ne ditet e mepastajme".  
Gjeneza 49:1 O:"Skeptri dhe ligjvenesit nuk do ta ikin prej Judes, deri me ditën kur te mberrija Shilohu: atij do t'i takoja atehere bashkajetesa e popujve."  
Me emrin Shiloh gjejme edhe nje qytet ne Bibël por kuptimi i vertete i kesaj fjale eshte paqe, qetesi, prehje d.m.th. Islami. Duket qarte se ky kuptim nuk mund te kete lidhje me qytetin e quajtur Shiloh dhe po qe sa do ti referohej nje personi, do ta ishte vecçse nje shtremberim i fjales Shaluah (Elonim) d.m.th. i derguar (i Allahut).  
Pra, vijimesia e Profeteve te Izraelit, nspermjet. pasardhesvQ te Isakut , do ta nderpritej kur te shfaqej Shilohu. Kjo korrespondon me ate çka thuhet ne Suren 2:133:"A qete deshmitare ne kohen kur Jakovin e mori vdekja? Kur ai u tha te bijve: Cfare do te adhuroni pasi une te kern vdekur? E ata i thane: "Ne do te adhurojme Zotin tend(Allahun), Zotin e eterve te tu Abrahamit Ismailit dhe Isakut. Nje Zot do t'i falemi e vec; Atij do ti jemi dorezuar!"  
Po keshtu, edhe ne Xheremia paralajmerohet se Profetet tani e tutje do te dalin nga nje populi tjeter. Xheremia 31 :36:" Po qe se keto urdhera nuk do te zbatohen me-tha Perendia, -atehere pasardhesit e izraelit nuk do te jene me populli im".E njejta gje nenkuptohet edhe ne Ungjillin e Mateut 21 :43:" Prandaj ju

the[B]Muslimani---- privilegji i sherbimit te Perendise, do t'ju hiqet. Do t'i jepet popullit qe do te veproje sipas kerkesave te kesaj porgjegjesie."/B]

#### A PERMENDET MEKA NE BIBEL "BEKA" ESHTË MEKKA

Ne Meke ndodhet Ka'ba (Qabeja) e Shenjte, ndertuar prej Ibrahimit( Abrahamit) dhe birit te tij Ismail. Emri "Meka" (Makkah) eshte perdorur me shume se nje here ne Kur'anin e Lavdishem ne Suren 48:24. Nje emer tjetër për Meken është "Bcke", qe vjen si rezultat i ndryshimeve ns shqiptim midis fiseve te ndryshme arabe. Edhe emri Beke eshte permendur me shume se nje here ne Surah 3:96. "Me te vertete:Shtepia e pare, (Xhamia) e ndertuar per njerez, eshte ajo qe u ngrit ns Beke( MEKKA) e dobishme, udherrefyese per mbare njerezimin.". Eshte vertete e mahnitshme por fjala Beke permendet edhe nga Profeti Daut(David) (PQMT) ne Psallmin 84:6:" Ndersa kaluam neper luginen e Bekes, ata ndertuan nje pus, dhe shiu i rrembyer mbushi vend in plot pellgje te medha." Pus i permendur prej Profetit David, eshte pusi i mirenjohur "Zemzen" i cili ekziston edhe sot e kesaj dite ne afersi te Ka'bes.

#### SHTËPIA E LAVDISE TIME THOTE ZOTI

Isaja, kapitulli 60:

- 1."Ngrihu e ndrìço, pasi drita jote mberriti dhe mbi ty qendron lavdia e Perendise." Krahasoje me Suren 74:1-3:" 0 ti i mbuluar. Ngrihu dhe terhiq verejtjen (duke i thirrur). Dhe madheroje Zotin tend!"
- 2."Veshetro perreth, token e ka mbuluar erresira dhe popujt Jane te zhytur ne terr, por permbi ty do te ngrihet Perendia dhe lavdia e tij do te te shfaqet." Profeti Muhamed (PQMT) erdhi ne nje kohe te erret; kur bota e kishte harruar se Perendia eshte Nje, ashtu siç kish predikuar Ibrahimit(Abrahami) dhe profetet e tjere, perfshi edhe Isain (Jezusin).
- 3."Drita jote do te ndrìçoje kombet dhe sundimtaret do te dalin nga erresira e nates ne shkelqimin e agimit tend". ..
- 4."Ngrej syte e hidh veshtrimin perreth. Ie gjithë do te vijne e do te mblidhen rreth teje. Ne me pak se 23 vjet u arrit te kryhej bashkimi i tere Arabise.
- 5."...tek ty do te vije begatia e deteve dhe pasurite e popujve." Ne me pak se nje shekull, Islami u perhap ne Arabi dhe ne vendet e tjera.
- 6."Toka jote do te mbushet me tufa devesh te Midianit dhe , Efeut. Njerezit do te vijne nga Sheba duke sjelle flori e temjan e duke levduar Perendine." . ,
- 7."Kopete e Kedarit do te mblidhen rreth teje dhe ti do te zoterosh gjithë deshte e Nebaitit, te cilat une do ti pranoj si kurban ne Altarin tim dhe si shenje adhurimi ndaj shtepise se lavdise Time." Fiset e Kedarit (Arabise) u bashkuan "Shtepia e lavdise Time" i referohet Baneses se Allahut ne Meke dhe jo Kishes se Krishtit siç mundohen ta komentojne disa studiues kristiane. Eshte fakt I pamohueshem qe, fshatrat e Kedarit (ku perfshihet te pakten tere Arabia Saudite) jane i vetmi vend ne bote qe kane mbetur te pacenuara nga influenza e Kishes.
- 8"portat e tua nuk do te mbyllen kurre, por do te qendrojne hapur ne dite apo

nate. Drejt tyre do te marshojne plot triumf sundimtaret e fuqishem e ato do te pranojne brenda tyre begatine e popujve". Eshte po ashtu fakt se xhamia qe rrethon Ka"ben e Shenjte ne Meke ka ndenjor gjithnje e hapur, ditën dhe naten., . duke nisur qe nga koha kur Profeti Muhamed (PQMT) e pastroi nga idhujt e huaj, , prej qe 1400 vjet me pare. Per Haxhillek (Pelegrinazh)kane ardhur si njerezit e thjeshte, ashtu edhe sundimtaret.

## KOCI ME GOMER DHE KOCI ME DEVE

Ne Isaja 21 :7 thuhet se Isajes iu shfaqen ne nje vegim dy kalores:"Dhe ai pa nje koci e dy kalores, nje koci me go mere dhe nje koci me deve:..." Cili ishte ky kalores i hipur mbi gomar? Cdo nxenes i shkolles se te Djeles e di. Ky ishte Jezusi (Gjoni 12:14):" Jezusi kishte gjetur nje kerriç qe e ngiste, siç thuhet ne shkrimin e Shenjte," Cili eshte pra ky kalores i premtuar, i cili do te vije mbi deve? Ky Profet i fuqishem eshte anashkaluar nga lexuesit e Bibles, Ky eshte Profeti Muhammed (PQMT). Nese keto fjale nuk i perkasin atij, atehere profecia nuk eshte permbushur akoma. Kjo eshte edhe arsyeja perse Isaja, ne po te njejtin kapitull thote Isaja (21 :13):" Barra mbi Arabine..," qe do te thote pergjegjesia qe rëndon mbi gjithë Muslimanet arabe, dhe sot, pa tjetër mbi tere muslimanet, per te perhapur mesazhin e Islamit.Kurse keto e kane perkthyer kunder arabise. Isaja 21 :14:"Banoret e Ternes u dhane uje atyre qe ishin te etur, dhe u dhane buke ikanakeve te gjore." Ka shume mundesi qe Tema te jete Medina ku u strehua Profeti Muhammed dhe shoket e tij. çdo ikanak (emigrant)u be vella me nje banor te Medines, i cili i dha buke e shtepi, Isaja 21 :15: "Ata u larguan nga shpata e nxjerre nga milli, nga harku i tendosur dhe nga zjarri i betejes," Ketu flitet per Profetin Muhammed (PQMT) dhe shoket etij, te cilet iu nenshtruan shume persekutimeve e keshtu u detyruan te lene Mekken e te vene ne Medine. Isaja 21 :16:"Perendia me tha: Brenda nje viti, tere madheshtia e Kedarit do te marre fund." Dhe vertet, ne vitin e dyte te Hixhrit (mergimit), paganet u munden ne betejën e Bedrit.

Isaja e mbyll kapitullin e 21 keshtu: " ushtaret e fuqishem te Kedarit do te pakesohen: sepse keshtu tha Perendia, Zot i Izraelit" .Kedari eshte djali i dyte i Ismailit (Gjeneza 25:13) nga i cili erdhi Profeti Muhammed (PQMT). Ne fillim Muhammedi dhe shoket e tij u sulmuan prej njerezve te Kedarit. Por shpejt shume prej tyre e pranuan Islamin e keshtu u pakesua numri i atyre qe i kundërshtonin Muhammedit. Ne mjaft vargje te Bibles, "Kedari" eshte sinonim i fjales " arab", duke marre kuptimin pergjithsues, si ne Ezekiel 27:21 :"Arabia, dhe gjithë Prineerit e Kedarit...".

## PROFETI QE DO T'I NGJANTE MOISIUT

Perendia iu drejtua Moisiut (Deuteronomia 18:18): "Prej vellezerve te tyre do te dale nje Profet i cili do te jete si ty (Moisi) dhe ne gojen e tij une do te ve fjalet e

mia, e ai do t'u transmetoja atyre urdherat e keshillat e mia".

1. Ismaelitet (pasardhesit e Abrahamit, perveç Ismailit, jane vellezer te Izraeliteve (pasardhes te Abrahamit permes Isakut). Ne kete rast Jezusi perjashtohet te jete profeti i premtuar, pasi ai eshte Izraelit; ndryshe aty do te thuhej "nje Protet nga mesi i juaj."

2. A nuk i ngjan Muhammedi Moisiut? Po qe se kjo nuk pranohet, atehere ky premtim i Perendise nuk eshte permbushur akoma. Tabela e meposhtme, shkeputur nga Al-Ihihad, Janar -Mars 1982 tq.41, flet vete:

Me poshte jepet nje table krahasuese ndermjet karakteristikave kryesore te Moisiut, Jezusit dhe Muhamedit ne menyre qe te kuptohet se cili eshte "Proteti" i cili do te vije pas Moisiut:


3. "[dhe do te ve na gojen tij fjalet e mia." Pra lajmi i Perandisa erdhi permes Xhebrailit (Gabrielit) dhe'jo permes arsyttimeve ta Profetit Muhammed. Por ketu nuk ka asgje per t'u çuditur pasi e njejta gje mund ta thuhet par tare Shkrimet e Shenjta. Arsyeja perse ketu kjo gje permendet kaq hapur, ndoshta vjen nga Fakti se besohet se Moisiut lajmi i Perandise i erdhi permes disa pllakave ta shkruara. Deuteronomi 18: 19: "Ai profet do te flase ne emrin tim dhe kushdo qe nuk i ve vesh fjaleve te tij, do te kete te beje me mua."

Nga 114 kapituj (Surah) qe ka Kur'ani,. 113 fillojne me shprehjen Ne emer te Allahut, Meshiruesit e Meshirberesit .Po me kete shprehje Muslimanet fillojne punet e tyre te perditshme. Ne vend te fjales Perendi, muslimanet perdorin emrin e Tij Personal qe eshte Allah. Ky emer, duke qene i pervçem nuk ka as gjini e as numer shumes. Ndersa kristianet, nga ana e tyre lutjet i nisin me fjalet".Ne emer te Atit e te birit. e te Shpirtit te Shenjte.

Gjithashtu duhet vene re se ata, te cilet nuk e degjojne apo e mohojne Perendine do te ndeshkohen. Kjo korespondon me ate pjese te Kur'anit te Lavdishem (Sure 3:19): " Feja e pranueshme tek Allahu eshte Islami." (Sure 3:85): " E kush kerkon fe tjeter perveç fese Islame, atij kurrsesi nuk i pranohet dhe ai ne boten tjeter eshte nga te deshperuarit."

---

<b>Fusha e krahasimit</b>	<b>Moisiu</b>	<b>Muhamedi</b>	<b>Jezusi</b>
<b>lindja</b>	<b>E zakonshme</b>	<b>E zakonshme</b>	<b>E jashtezakonshme</b>
<b>Jeta familjare</b>	<b>martuar me femije</b>	<b>I martuar me femije</b>	<b>I pamartuar pa femije</b>
<b>Vdekja</b>	<b>E zakonshme</b>	<b>E zakonshme</b>	<b>E jashtezakonshme</b>
<b>Karlera</b>	<b>Profet / burrë shteti</b>	<b>Profet / burrë shteti</b>	<b>Profet</b>
<b>Emigrimi i detyruar (moshe! madhore)</b>	<b>Ne Median</b>	<b>Ne Medine</b>	<b>Askund</b>
<b>Ballafaqimi me armiqt</b>	<b>Ndjekje</b>	<b>Ndjekje - beteja</b>	<b>Asnje ballafaqim te tille</b>
<b>Rezultatet e ketij ballafaqimi</b>	<b>Fitore morale dhe fizike</b>	<b>Fitore morale dhe fizike</b>	<b>Fitore morale</b>
<b>Lajmion i zotit ashte shkruar</b>	<b>Gjate jetes (Teurafi)</b>	<b>Gjate jetes (Kur'ani)</b>	<b>Pas vdekjes</b>
<b>Natyra e mesimeve</b>	<b>Shpirtore dhe ligjore</b>	<b>Shpirtore dhe ligjore</b>	<b>shpirtore</b>
<b>Pranimi si udheheqes (nga populli)</b>	<b>U mohua e pastaj u pranua</b>	<b>U mohua e pastaj u pranua</b>	<b>U mohua (nga shumica e Izraeliteve)</b>

 ak.jpg (37.8 KB, 540x302 - E shikuar 22 Herë.)

## SHERBETORI, LAJMETARI DHE I ZGJEDHURI IM

Nje permbushje me e qarte e profecise se Muhammedit gjendet ne Isaja 42: ..1.Ky eshte sherbetori im, te cillin unImbroj, i zgjedhuri im qe zemren ma

gezon. Shpirti im do te qendroje mbi te e ai dote sjelle drejtesine mes kombeve." Ne vargun 19 ai quhet edhe" i derguari im". Padyshim qe te tere profetet kane qene sherbetoret, lajmetaret dhe te zgjedhurit e Allahut. E megjithate. asnje Profet nuk eshte quajtur me tituj te vecante si ate te Muhametit (PQMT) ne arabisht "Abduhu ve Resuluh dmth" rob dhe i derguari i Tij i zgjedhur." Lutja e nje njeriu, i cili pranon Islamin, eshte I tille "Une deshmoj se nuk ka asnje Zot tjetër pëveç Allahut i cili eshte i pashoq dhe une deshmoj se Muhammedi eshte rob dhe I derguari i Tij." Kjo formule perseritet 5 here ne dite nga xhamite si nje thirrje per fillimin e Ritit fetar, 5 here te tjera perpara fillimit le çdo lutjeje, nente here ne dite ne Teshahhud gjate kryerjes se lutjeve obligatore si dhe shtate here te tjera, po qe se muslimani kryen lutje shtese qe i jane keshilluar. Titulli me i zakonte qe perdorte per Profetin Muhammed (POMT) eshte Resulullah d.m.th. lajmetar i Allahut.

Isaja 42-2."Ai nuk do te vajtoje. nuk do te therrase e as zeri nuk do ti degjohet udheve." Kjo pershkruan dinjitetin e Profetit Muhammed (POMT).

3."...ai do te sjelle drejtesine."

4."Ai nuk do te nguroje apo dekurajohet ne qellimin e tij per te vendosur drejtesine mbi toke. Shpresa e idhujve do te mbeshtetet na ligjin e tij." Keto fjala duhen krahasuar me portretin e Jezusit i cili nuk doli fitimtar mbi armiqtë e tij dhe u zhgenjyer nga refuzimi i Izraeliteve."

5. "Une, Perendia, te kam rradhitur nder te drejtet; ti do te kesh gjithmone prane

doren time. Ti do te mbetesh e do le sherbesh si nje marreveshje qe une po bej me njerzimin, si nje drite e shkelqyer per tere Kombet."

"ti do te mbetesh" d.m.th., pas teje nuk do te vije asnje Profet tjarar. Ne nji) kohe mjaft te shkurter Islami u pranua nga nje numer i madh njerezish te pafe.

6. "t'u hapesh syte te verberve, te çlirosh te roberuarit nga biruca a te nxjerresh nga shpellat ata qe jane mesuar te jetojne ne erresire." "Syte e verbuar" "jeta ne erresire" keto fjale nenkuptojne jeten pagane." "Te çlirosh te verberuarit nga biruca" tregon zhdukjen e skilaverise, per te paren here ne historine e njerezimit.

. 7. "Une jam Perendia; ky eshte emri iml Lavdia ime nuk do t'i jepet asnje tjetri dhe as levdatat e mia nuk do t'u dhurohen idhujve". Profeti Muhammed (POMT) eshte unik ndermjat te tere Profeteve, pasi qe ai eshte "Vula e te tere profeteve" dhe mesimet e tij krahasuar me Kristiani----zmin apo Judaizmin kane mbetur te pandryshuara sot e kesaj dite.

8. "Kendojini Perendise nje kenge te re, levdojeni ate nga tere cepat e botes..." Kjo do te jete nje kenge e re, pasi nuk do te kendohet as ne Hebraisht a as ne gjuhen Armaike por ne arabisht. 5 here ne dite kendohet prej minareva te miliona xhamive ne te gjithë boten levdimi i Zotit dhe Lajmetarit te Tij Muhammed (PQMT").

9. "I'a ngrene zerin qytetet dha hapsirat e shkretetires, te gezojne fshatrat ku jeton Kedari

Te kendojna nga gezimi tere populli i Seles

Te bucasin thirrjet e tyre nga majat e maleve."

çdo vit haxhinjte e ardhur ne Meke kendojne nga majat e malit Arafat keto fjale".Ja ku erdha una ne sherbimin Tend 0, Allah. Ja ku erdha. Ja ku erdha. Ti je i pashoq. Ja ku erdha Yti eshte lavdimi, bekimi dhe sovraniteti. Ti je i pashoq."

Kapitulli 42 i Isajes nuk mund ti referohet kurre nje Profeti Izraelit pasi Kedari eshte biri i dyte i Ismailit.

Shih Gjenez 25:13.

10. "T"i japin lavdi Perendise dhe te perhapin neper ishuj levdimin e Tij.

Dhe me te vertete Islami u perhap ne shume ishuj te vegjel deri ne Indonezi dhe ne Detin e Karaibeve.

11. "...ai do te dale fitimtar mbi armiqtë e tij" Me ardhjen e Muhamedit a.s (PQMT) ne nja kohe te shkurter u vendos mbi Toke Mbreteria e Zotit.

Kapitulli i 42 i Isajas perputhet plotesisht mo karakterin e Profetit Muhammed (POMT).

## BEKUAR QOFSHIN PAJTUESIT"

Ne predikimin e mbajtur ne mal, Jezusi tha (Mateu 5:9): "Bekuar qofshin pajtuesit sepse ata do te quhen bijte e Perendise".

Fjala Islam nenkupton Paqe; paqe ndermjet krijuesit dhe adhuruesve. Jezusi nuk mund te hyje tek pajtuesit pasi ai nuk erdhi per paqen (Mateu 10:3436):" Mos mendoni sa erdha qe ta sjell paqen ne bote. Nuk erdha per t'ju sjelle paqen, por

perçarjen. Erdha ta ndaj birin nga i ati, vajzen nga nena, nusen nga vjehrra. me te afermit do te jene armiqte me njeri-tjetrin." Shih po ashtu Luka 12:49-53.

## NDIHMESI ,SHPIRTI I SE VERETETES (MUHAMEDI A.S)

25 Ju kam thënë këto gjëra, ndërkaq jam me ju;

26 por Ngushëlluesi, shpirti i se vertetes , që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t`ju mësojë çdo gjë dhe do t`ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë.

27 Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time(Islamin): unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë.

30 Nuk do të flas më gjatë me ju, sepse po vjen princi i kësaj bote dhe ai nuk ka asgjë në mua; {behët fjale për Muhamedin a.s gjoni 14}

{gjoni 15-26 }Por kur të vijë Ngushëlluesi, që do t`ju dërgoj prej Atit, Fryma e së vërtetës, që del nga Ati im, ai do të dëshmojë për mua.{vertet kuani ma ane te profetit Muhamed a.s ka deshmuar per jezusin

[gjoni 16-7 -8-9-10 ...]

Megjithatë unë ju them të vërtetën: është mirë për ju që unë të shkoj, sepse, po nuk shkova, nuk do të vijë te ju Ngushëlluesi; por, po shkova, unë do t`jua dërgoj. Kush qeka ky person qe do vinte dhe qe qeka me I mire per nxenesit e jezusit sa vete jezusi saqe jezusi donte qe te ikte qe te vinte Ai(Muhamedi .as Dhe kur të ketë ardhur, ai do ta bindë botën për mëkat, për drejtësi dhe për gjykim.

Për mëkat, sepse nuk besojnë në mua;(si profet por si Zot)

për drejtësi, sepse unë po shkoj tek Ati dhe nuk do të më shihni më;

Por, kur të vijë ai, Fryma e së vërtetës, ai do t`ju prijë në çdo të vërtetë, sepse ai nuk do të flasë nga vetja, por do të thotë gjitha ato gjëra që ka dëgjuar dhe do t`ju kumtojë gjërat që do vijnë.

Ai do të më përlëvdtojë, sepse do të marrë prej meje dhe do t`jua kumtojë.

Të gjitha gjërat që ka Ati janë të miat; për këtë ju thashë se ai do të marrë prej simes dhe do t`jua kumtojë. A nuk ka treguar KUrani per Biblen dhe ngjarjet e Jezusit.

Gjoni 14:16:" Une do t'i lutem Atit qe t'ua jape Ndhimesin, per te me zevendesuar, Shpirtin e se Vertetes qe do te mbetet pergjithmone me ju".

Nuk dihet secila eshte ne te vertete fjala origjinale Aramaike perdorur nga Jezusi per fjalen "Ndhimes". Disa Bibla te tjera perdorin fjalet Ngushellues, Mbrojtes, Qetesues ndersa ne Biblen greke perdoret fjala "Paradete". Shpjegimet per kete fjale jane te ndryshme: Shpirti i Shenjte, Fjala, person i caktuar etj..

Kur'ani i Shenjte thote ne Suren 61 :6 se Jezusi permend haptazi emrin Ahmed:" Dhe (mbani mend) kur Isai (Jezusi) Biri i Merjemes (Marise) tha: O beni izraile, Une jam i derguari i Al/ahut te ju ,Jam vertetues I Teuratit qe ishte perpara meje dhe jam pergezuesper nje te derguar qe do te vije pas meje emri i te cilit do te jete Ahmed! E kur ai erdhi atyre me argumente te qarta, ato thone: Kjo eshte

magji e hapet (dmth emri.i dyte i Profetit Muhammed dhe qe fjale per fjale do te thote ai qe levdon Allahun me teper se gjithë te tjeret).

Sido qe te jete shpjegimi i fjales "Ndhimes", ne arrijme ne pertundimin se Jezusi . nuk arriti ta perfundonte misionin e tij dhe keshtu me pas do te vinte dikush tjeter per ta perfunduar ate. Le te shqyrtojme nen driten e atyre qe thote vete Bibla nese karakteristikat e ketij Ndhimesi te pritur perputhen me ate te Profetit Muhammed (PQT):

1."Nje ndihmes tjeter" Pra mjaft ndihmes kishin ardhur deri atehere, dhe tani pritej te vinte nje tjeter.

2. "qe do te mbetet gjithmone me ju." nuk do te qe me e nevojshme qe pas tij te vinte nje tjeter, ai ishte vula e tere Profeteve. Mesimet e tij do te jene perhere me njerezit, do te mbeten te pandryshuara. Dhe eshte fakt qe Kur'ani i Lavdishem dhe tere mesimet e tij kane mbetur te pacenuara ashtu sikurse ishin 1400 vjet me pare.

3."ai do tu tregoje njerezve te kesaj bote se c'eshte mekati" (Gjoni 16:8) te gjithë Profetet, duke pertshire edhe Abrahamin, Moisiun, Davidin dhe Solomonin, i kane ndeshkuar rende mekatet e te afermeve te tyre dhe te njerezve qe njihnin, por asnje nuk eshte marre me mekatet e nje bote te tere siç beri Muhamedi. Ai jo vetem qe shkuli nga rrenjet ne Arabi brenda 23 vjetesh zakonin e adhurimit te idhujve te ndryshem por dergoi gjithashtu edhe keshilltaret e tij prane Herakliut, prane sovraneve te perandorive Persiane dhe Romake, prane Najashit, Mbretit te Etiopise dhe Mukakisit,Guvernatorit te Egjiptit.

Ai i qortoi kristianet, sepse kishin percare unitetin e Perendise ne nje Trini dhe e kishin ngritur Jezusin ne Bir te Perendise, madje ne vete Perendine.Ishte Muhamedi ai qe i denoi Cifutet dhe kristianet per falsifikimin e Shkrimeve te Shenjta, ishte ai qe shpalli te drejtat e ligjshme te Ismailit (PAQMT) dhe u hoqi Profeteve balten qe u ishte hedhur, duke i akuzuar per shkelje kurore, incesti, perdhunim dhe adhurim idhujsh te ndryshem.

4. Sundimtari i kesaj bote tashme u denua " (Gjoni 16:11). Ky eshte Satanai qe pershkruhet edhe ne Ungjillin e Gjonit 12:31 dhe 14:30. Pra Profeti Muhammed (paMT), erdhi ne kete bote per te zbatuar urdherin e dhene nga gjyqi i Perendise.

5."Shpirti i te vertetes" (Gjoni 16:13) Qe ne femijerine e tij Profeti Muhamed eshte quajtur El-Emin dmth I ndershmi apo i verteti, dhe" ai do t'ju udheheqe drejt te vertetes.. "(Gjoni 16:13).

6."Ate qe do t'jua thote, nuk do ta marre prej vetvetes por do t'ju thote ate qe degjon" (Gjoni 16:13)

Kur'ani i Lavdishem eshte fjale e Perendise. Ne te nuk eshte perfshire asnje fjale e Profetit Muhamed apo e ndonjerit prej shokeve te tij. Cdo fjale e atij libri, atij iu lexua prej engjellit Xhebrail(Gabriel), ai i mesoi permendesh dhe ua diktoi shkrueseve te tij. Theniet dhe mesimet e tij jane permbledhur ne Hadithet qe do te thote Tradite (shumes Hadithet).

Krahaso me Deuteronomin 18:18... ne goje do t'i ve fjalet e mia: dhe ai do t'u thote qto qe do ti them Une."Kjo korrespondon me Suren 53:2-4: "Shoku juaj {Muhamedi) as nuk eshte njeri qe ka humbur, as qe ka devijuar( nga e verteta). Dhe ai nuk flet nga mendja etij. Ai (Kur'ani) nuk eshte tjeter pos shpallje qe i shpallet."



7, "Dhe do t'ju .tregoje per gjeret e ardhshme" (Gjoni 16:13). Te tera profecite e Profetit Muhammed jana vertetuar plotesisht.

8. "Ai do te beje te dukshme madheshtine time" (Gjoni 16:14). Ne te vertete Kur'ani i Lavdishem dhe Profeti Muhammed kane per Jezusin me teper respekt sesa vete Bibla dhe kristianet. Kete e vertetojne edhe cka thuhet me poshte:  
a. Te besosh se ai vdiq, ne kryq do te thote te diskreditosh qenien e tij si profet duke u bazuar kjo tek Deuteronomi 13:5: " Dhe ai profet apo enderrimtar, do te denohet me vdekje..." Perseri. sipas Deuteronomit pohimi i mesiperme do t'i vinte atij vulen e te mallkuarit (Mos O Allah!): ". ..pasi ai qe do te vdese me varje eshte i mallkuar nga perendia..."

b. Mateu 27:46: "...Perendia im, Perendia im pese hoqe dore prej meje" te mundet te thonte Jezusi keto fjale? Edhe nje joprofet do te buzeqeshte ne ata momente te vdekjes pasi e dinte se kjo vdekje do t'i jepte titullin e martirit. A nuk eshte kjo nje fyerje ndaj Jezusit duke e paraqitur ate sikur nuk ka besim ne Allahun? .

c. Ne myslimanet nuk mund ta besojme kurre se Jezusi do te mund ti etiketonte joçifutet me emrat qen dhe derra si dhe do te mund ti drejtolej te ernes me fjalen Grua. Ne Kur'anin e Lavdishem, Sure 19:32 thuhet " Me ka bere te miresjellshem ndaj nenes sime, e nuk me ka bere kryelarte as te padegjueshe[B]Muslimani----" [/B]Ndersa Mateu 7:6 thote: "Mos u jepni qenve per ushqim gjera te shenjta: Mos i hidhni para derrave margaritare tuaj...". Gjoni 2:4 "Jezusi iu pergjegj MARIËS; Grua, se (çdo te bej une, eshte puna ime e jo puna jote?

#### ZOTI I REVELON (SHPALL) PROFETIT MUHAMMED (PQMT)

Fjala e pare qe Perendia i tha Muhammedit permes engjellit Gabriel ishte fjala "Ikra" qe do te thote "Lexo", Suren 96: 1-5. Muhammedi, duke qene qe ishte analfabet iu pergjigj: "Une nuk mundem te lexoj". Kjo shpallje e pare e Perendise profetizohet edhe ne

Isajan 29:12: " Dhe libri dot'i jepet atij qe nuk eshte i mesuar me fjalet : Lexoje kete: Vetem ty te lutem dhe ai do te thote: Une nuk jam i mesuar. "

Rradha e revelacioneve te bera nga Allahu nuk perputhet rre rradhitjen e tyre ne Kur'an. Me fjale te tjera shpallja e pare nuk jepet ne faqen e pare dhe shpallja e fundit nuk jepet ne faqen e fundit. Menyra e rradhitjes sa ketyre shpalljeve na Kur'an eshte vendosur nga Allahu dhe kjo jepet madje edhe ne Isaja 28:10-11 : "Pasi aio duhet te jete mendimi mbi mendimin, mendirni mbi mendim; rreshti mbi rresht. pak ketu e pak atje: me buze te dridhura e me nje gjuhete huaj ai do'tu drejtohet njerezve." Gjuha e huaj ka katu kuptimin e nje te foluri tjetere qe nuk eshte as Hebraisht e as aremaike, por arabishtja.

Myslimanet ne tere boten i drejtohen Zotit, i thone Lutjet dhe sherbesat fetare vetem ne nje gjuhe, ne arabisht. Edhe ky unitet gjuhesor eshte profetizuar ne librin e Zefanise 3-9 "Ndaj une do tu jap njerezve nje gjuhe te paster qe ata te mund t'i drejtohen Perendise me nje ze dhe ti sherbejne Atij te bashkuar". Keshtu pra e verteta erdhi ne arabisht ndonse disa vazhdojne ende te besojne se Profeti Jezus do te kthehet e do ti mesojte njerezit te levdojne Perendine ne nje

gjuhe unike. Ne muslimanet jemi te sigurt se kur te kthehet Jezusi ai do te bashkohet ne nje xhami me muslimanet pasi ai eshte njelloj si cdo mysliman. i bere synet, nuk e ha mishin e derrit dhe i kryen ritet fetare, duke u lare, duke u gjunjzuar e duke u shtrire perpara Allahut.